

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kylie Jenner “i zemëron” ndjekësit me fluturimin 17-minutësh me avionin privat? Pse? Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/kylie-jenner-i-zemer-on-ndjekesit-me-fluturimin-17-minute-sh-me-avionin-privat-pse/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 22:34:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 22:22:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	227918ea8ef93ee5ae24da9b876300ae6013b6ca844b5d74ea7e2743335f09ed
TEKSTI	8d86eb3090b891fc9ff526f4dbd34d7c68aa87f6f6157d5f9bfb9e1707449335
PAMJA	bf10ac0466eb43fd1d738f84916a0e8850a2d57cea3ce4dc0952dc7393d7809f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fdd21be17a16000d82f0b5bc8ae3b07a050bae8e12ca4f79f0fbed2dccd63163
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	5345adcd1aa94d26a715684b051fd1b2f60064832993062139e0dcea4687825f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fdd21be17a16000d82f0b5bc8ae3b07a050bae8e12ca4f79f0fbed2dcd63163>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Kylie Jenner “i zemëron” ndjekësit me fluturimin 17-minutësh me avionin privat? Pse?



Redaksia K

17 Shtator 2026



Kylie Jenner është sërish në qendër të kritikave për përdorimin e avionit të saj privat, pasi një fluturim i fundit prej vetëm 17 minutash ka shkaktuar reagime të shumta në rrjetet sociale.

Sipas të dhënave të gjurmimit të fluturimeve, avioni i lidhur me Jenner udhëtoi nga Van Nuys drejt Camarillo, Kaliforni, në një distancë prej rreth 30 miljesh detare. Të dhënat e publikuara nga platformat e gjurmimit e regjistronë fluturimin me një kohëzgjatje prej rreth 17 minutash.





Lajmi u rikthye në vëmendje pasi një faqe në Instagram, e quajtur “S**t you should care about”, publikoi informacionin dhe pretendoi se udhëtimi mund të ketë kushtuar rreth 3 mijë dollarë.

HEY KYLIE

WE'VE WATCHED YOU TAKE A 17 MINUTE PRIVATE JET FLIGHT FROM CAMARILLO TO VAN NUYS.

A JOURNEY THAT COST AN ESTIMATED \$3 THOUSAND.

39.0 mi
41 min
82.9 km

You could have funded life-saving pneumonia treatment for 600 CHILDREN in Sudan with what it cost you to avoid a 45-minute drive.

Fajta kritikoi përdorimin e një avioni privat për një distancë kaq të shkurtër, duke e lidhur çështjen edhe me ndikimin mjedisor të aviacionit privat.

Reagimet e përdoruesve nuk vonuan. Një komentues e cilësoi situatën si “genuinely revolting”, ndërsa të tjerë kritikuan miliarderët dhe të pasurit për mënyrën se si përdorin avionët privatë.



Këta miliarderë vërtet nuk mendojnë fare për planetin

-shkroi një tjetër përdorues, ndërsa dikush tjetër argumentoi se udhëtimi mund të ishte bërë me makinë dhe akuzoi Jenner për një përdorim “të tepruar” të avionit.

Por jo të gjithë ishin kundër **Jenner**. Disa ndjekës e mbrojtën yllin e “The Kardashians”, duke vënë në dukje se trafiku në zonën e Los Angeles mund të jetë i paparashikueshëm dhe se një udhëtim që në kushte ideale mund të zgjasë më pak se një orë mund të marrë shumë më tepër kohë në rrugë.



Ndonjëherë ajo rrugë zgjat 45 minuta, ndonjëherë tre orë

-shkroi një përdorues.



Një tjetër ishte edhe më i drejtpërdrejtë:



Edhe unë do ta bëja të njëjtën gjë po të kisha një avion privat.

Nuk është hera e parë që përdorimi i avionit privat nga **Kylie Jenner** bëhet objekt debati. Ajo ishte përballur me një valë të ngjashme kritikash edhe në vitin 2022, kur një tjetër fluturim i saj prej 17 minutash mes Camarillo dhe Van Nuys u bë viral. Në atë kohë, “Los Angeles Times” raportoi se distanca mund të përshkohej me makinë për rreth 45 minuta, në varësi të trafikut.

Megjithatë, përdorimi i të dhënave të fluturimeve të shkurtra kërkon edhe një sqarim. Një analizë e “Forbes” në vitin 2022 vuri në dukje se fluturimet e shkurtra të avionëve privatë nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht se pronari ndodhet në bord. Avioni mund të zhvendoset për arsye operationale, mirëmbajtjeje ose për t’u parkuar në një aeroport tjetër.

Në rastin e udhëtimit të fundit, nuk ka një deklaratë publike nga Jenner që të shpjegojë arsyen e saktë të fluturimit apo nëse ajo ndodhej personalisht në avion. “The Sun” raportoi se kishte kërkuar

koment nga përfaqësuesit e saj, por nuk kishte marrë një përgjigje.

Debat, megjithatë, shkon përtej Kylie Jenner. Avionët privatë janë prej kohësh në qendër të kritikave për ndikimin e tyre disproporcional në emetimet e karbonit, ndërsa udhëtimet shumë të shkurtra janë veçanërisht të diskutueshme për shkak të emetimeve që lidhen me ngritjen dhe uljen e avionëve.

Kështu, një fluturim që zgjati vetëm 17 minuta është kthyer sërish në një debat të madh online për luksin, jetën e të famshmëve dhe çmimin mjedisor të udhëtimeve me avion privat.

LAJME TË NGJASHME



E bleu 6 vite më parë, Kylie Jenner ende nuk është zhvendosur në shtëpinë e saj? Pse?

1 MIN



Kylie Jenner rrëfen pendesën për një nga blerjet e saj më të mëdha: "E humba kontrollin e jetës sime"

1 MIN



Kylie Jenner zbulon motrën e saj të preferuar: "Sot do të ishte..."

1 MIN



Kylie Jenner habit fansat me pamjen gjatë trajtimit estetik: "Vajzë e çmendur"

1 MIN



"I dua më të mëdha, aq sa..." / Ylli i njohur televiziv habit me deklaratën e saj për operacionin e radhës!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Sot verdikti i Hagës/ Konjufca: Presim vetëm një vendim, lirimin e katër ish-krerëve të UÇK-së



Charles Smith kryeson trupin gjyqes në Hagë



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Trupi gjyqes: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte




Gjykata speciale në Hagë jep sot vendimin për Thaçin dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim



Haga/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Kush janë gjyqtarët që do të shpallin sot vendimin për ish-krerët e UÇK-së në Hagë?



Nis seanca në Hagë për shpalljen e vendimit për Thaçin, Veselin, Selimin e Krasniqin

EDITORI SUGJERON



10 sheniat që tregojnë se ushqimi



TOP ALBANIA RADIO



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut
është më i mirë për sheqerin në
gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të
viçit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton
hormonin që prodhohet gjatë
aktivitetit fizik intensiv!



Çfarë nuk duhet të mungojë në
dietën tuaj për flokë të
shëndetshëm...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.